

KESHILLI I QARKUT SHKODER

VENDIM

Nr. 10, datë 09.07.2024

Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 02, datë 26.03.2020, Rregullore e Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër

*Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër*

Këshilli i Qarkut Shkodër në mbledhjen e tij të datës 09.07.2024, bazuar në: Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 77 germa ç), mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 02, datë 26.03.2020, Rregullore e Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër,

pas diskutimeve të anëtarëve të tij;

VENDOSI:

- Të miratojë disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 02, datë 26.03.2020, Rregullore e Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër "Për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër", sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

